



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1172/ 21 prot.

Datë 18.06.2025

V E N D I M

Nr. 789/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.06.2025 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike*”, me nr. REF-44148-04-08-2025, me objekt: “*Mbikëqyrje punimesh për objektin: Ndërtim-montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A*”, me fond limit: 1,249,423.86 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

Ankimues:

Operatori ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK me NIPT L11807013M dhe adresë Njësia Bashkiake nr. 7, Rruga Dritan Hoxha, Ndërtesa nr. 117, Shkalla nr. 2, Apartamenti nr. 5/3, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Albpetrol sh.a. me adresë Lagja “29 Marsi” Patos, Selia Rruga Fier – Patos, km 7.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4.Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 09.04.2025, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike”, me nr. REF-44148-04-08-2025, me objekt: “Mbikëqyrje punimesh për objektin: Ndërtim-montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”, me fond limit: 1,249,423.86 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

II.2. Në datën 22.04.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 25.04.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- 1. OE “C.E.C GROUP” shpk 1,086,998.76 I Skualifikuar**
2. OE “G B Civil Engineering” shpk 1,091,676.4 I Kualifikuar
3. OE “NET-GROUP” shpk 1,109,229.50 I Kualifikuar
4. OE “HYDRO-ENG CONSULTING” shpk 1,112,130 I Kualifikuar
5. OE “MIKI CONSULTING” shpk 1,124,176.97 I Kualifikuar
6. BOE “Bersant Ylli” pf & “XH & MILER” shpk 1,137,946.92 I Kualifikuar
7. OE “MAGNA CHARTA” shpk 1,144,507.56 I Kualifikuar

II.4. Në datën 30.04.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftimin e Fituesit Paraprak, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 23, datë 05.05.2025, ku është shpallur fitues OE “G B Civil Engineering shpk”.

II.5. Në datën 06.05.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5292 dhe me nr. 1172/2025 prot., datë 06.05.2025 e operatorit ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1172/1 prot., datë 07.05.2025.

II.7. Nëpërmjet komunikimit elektronik, autoriteti kontraktor më datë 07.05.2025 i është drejtuar subjektit ankimues për korigjim të metash të formularit të ankesës, pasi nuk është i shoqëruar me mandat bankar. Për këtë, ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, e-mail protokolluar me tonën me nr. 1172/2 prot., datë 09.05.2025

II.8. Nëpërmjet komunikimit elektronik, më datë 07.05.2025 subjekti ankimues “C.E.C. GROUP” SHPK, ka dëguar me email dhe ka vënë në dispozicion të KPP-së, mandat pagesën, protokolluar me tonë me nr. 09.05.2025.

II.9. Me shkresën me nr. 1172/4 prot., datë 09.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua, autoritetit kontraktor Albpetrol sh.a., me kërkesë për informacion të detajuar mbi procesverbalin e përllogaritjes së fondit limit të projektit të zbatimit me objekt “ *Ndërtim-montim i disa RVM-*

ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”, referuar të cilit autoriteti kontraktor ka përllogaritur fondin limit të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me REF-44148-04-08-2025, me objekt: “Mbikëqyrje punimesh për objektin: Ndërtim-montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”.

II.10. Nëpërmjet komunikimit elektronik, me shkresën përcjellëse me nr. 2334/3 prot, datë 12.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1172/5 prot., datë 13.05.2025, me objekt: “Dërgim Vendimi”, është përcjellë nga autoriteti kontraktor Vendimi i Komisioni i Shqyrtimit të Ankeave, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK, mbi procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar vendimit të KSHA-së, rezulton se, kjo e fundit **e ka refuzuar.**

II.11. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektornike, me shkresën protokolluar me tonë me nr. 1172/6 prot., datë 13.05.2025, operatorit ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK, ka dërguar informacion shtesë.

II.12. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse me nr. 2334/3 prot, datë 12.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1172/7 prot., datë 19.05.2025, me objekt: “Dërgim vendimi”, është përcjellë nga autoriteti kontraktor informacioni i kërkuar.

II.13. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën protokolluar me tonë me nr. 1172/8 prot., datë 19.05.2025, operatorit ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK, ka dërguar informacion.

II.14. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse me nr. 2418/1 prot, datë 19.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1172/9 prot., datë 22.05.2025, me objekt: “Dërgim informacioni”, është përcjellë nga autoriteti kontraktor informacioni i kërkuar në përgjigje të shkresës së KPP-së me nr. nr. 1172/4 prot., datë 09.05.2025.

II.15. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, vendos të thërrasë ekspertin e fushës për të verifikuar nëse përllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është bërë konform bazës ligjore të përcaktuar, e më konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

II.16. Eksperti zgjidhet nga lista vjetore e ekspertëve të miratuar në përputhje me nenin 24 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

II.17. Eksperti i parë në rend alfabetik i cili referuar dokumentacionit zotëronte kualifikimet e kërkuara për kryerjen e ekspertizës është Ekspertia Znj.Arta Tani, e cila do të asistojë, Komisionin e Prokurimit Publik, në zgjidhjen e çështjes objekt-ankimi. Në datën 09.05.2025 u komunikua me telefon, nga telefoni i zyrës së protokollit, me ekspertin Znj.Arta Tani. Ekspertia

pranon, se është e specializuar për përllogaritjen e kostove për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim dhe përcaktoi tarifën prej 50,000 lekë për kryerjen e ekspertizës. Pas paraqitjes së saj, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u dakortësua asistenca e saj, në zgjidhjen e çështjes objekt-ankimi sipas procesverbalit të datës 12.05.2025. Gjithashtu, Ekspertia pranon se për kryerjen e ekspertizës i nevojiten 7 ditë kohë nga marrja e dokumentacionit.

II.18. Me Vendimin e Ndërmjetëm me nr. 693/2025 datë 26.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

- 1. Të urdhërojë kryerjen e Ekspertimit të Posaçëm lidhur me përllogaritjen në vlerën minimale dhe maksimale të fondit limit, nga eksperti i përzgjedhur nga lista e ekspertëve vjetorë të miratuar për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike”, me nr. REF-44148-04-08-2025, me objekt: “Mbikëqyrje punimesh për objektin: Ndërtim-montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”, me fond limit: 1,249,423.86 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.*
 - 2. Operatori ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK të parapaguajë për llogari të znj. Arta Tani, shumën prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë si tarifë e përcaktuar për kryerjen e ekspertimit dhe të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit brenda datës 29.05.2025 ora 12:00.*
 - 3. Autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik ankimues “C.E.C. GROUP” SHPK të paraqesin pretendimet e tyre me shkrim mbi çështjet që duhet të trajtohen nga Eksperti brenda datës 29.05.2025.*
 - 4. Në datën 30.05.2025 ora 12:00 të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik eksperti znj. Arta Tani, për marrjen në dorëzim të dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e ekspertizës.*
 - 5. Eksperti ngarkohet të kryejë aktin e ekspertimit dhe të dorëzojë materialin në formë shkresore. Akti i ekspertimit të dorëzohet jo më vonë se data 06.06.2025.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.19. Me shkresën përcjellëse me objekt “Dërgim vendimi” me nr. 1042/12 prot., datë 27.05.2025 Komisioni i Prokurimit Publik, iu dërgua me shërbim postar Vendimin e Ndërmjetëm me nr. 693/2025 datë 26.05.2025 për OE “C.E.C. GROUP” Sh.p.k.

II.20. Me shkresën e datës 29.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1172/13 prot., datë 29.05.2025, nëpërmjet komunikimit elektronik, operatori ekonomik ankimues ka dërguar me email në adresën zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik formularin e ankesës, argumentim si dhe mandat - pagesën, e cila vërteton kryerjen e pagesës në llogarinë e ekspertes Znj.A.T, në zbatim të vendimit nr. 693/2025, datë 26.05.2025 të KPP-së. Ndërsa, nga ana e autoritetit kontraktor nuk u paraqit brenda datës 29.05.2025, asnjë përfaqësues për pretendime me shkrim, mbi çështjet që duhet të trajtoheshin nga Eksperti.

II.21. Me shkresën nr. 1172/14 prot., datë 29.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik i ka dërguar ekspertes Znj.A.T, pyetjet që shtrohen për zgjidhje nga ana e saj, lidhur me procedurën e prokurimit objekt - ankimi. Konkretisht ekspertes i janë parashtruar këto pyetje:

1. *A është përllogaritur fondi limit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi nga autoriteti kontraktor në përputhje me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”?*
2. *Sa është kufiri minimal dhe maksimal i shërbimit të supervizimit për procedurën e prokurimit “Ndërtim-montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A” me fond limit 59 897 190 lekë pa tvsh, referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” ?*

Vlerat e llogaritura për kufijte minimalë dhe maksimalë të shërbimit të supërvizimit të jepen me dy shifra pas presjes. Gjithashtu, bashkëngjitur po ju vëmë në dispozicion edhe dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e akt ekspertimit lidhur me këtë procedurë prokurimi.

II.22. Me shkresën me nr. 1172/15 prot., datë 30.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua, autoritetit kontraktor Albpetrol sh.a., me kërkesë për informacion në lidhje me disa pyetje teknike të bëra nga ekspertia, Ing. A. T.

II.23. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën me nr. 2753/1 prot, datë 04.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 1172/16 prot., datë 09.06.2025, me objekt: “*Kthim përgjigje*”, është përcjellë nga autoriteti kontraktor informacioni i kërkuar në përgjigje të shkresës së KPP-së me nr. nr. 1172/15 prot., datë 30.05.2025.

II.24. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 1172/17 prto., datë 09.06.2025, Komisioni i Prokurimit Publik, i dërgoi ekspertes Ing. A. T, informacionin shtesë të dërguar nga ana e autoriteti kontraktor, në përgjigje të pyetjeve teknike të bëra nga ekspertia.

II.25. Në zbatim të vendimit nr. 693/2025, datë 26.05.2025 të KPP-së, me dokumentin e datës 16.06.2025, me objekt “*Raport ekspertimi*” protokolluar me tonën me nr.1172/18 prot., datë 16.06.2025, ekspertia ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, raportin e nënshkruar lidhur me procedurën objekt - ankimi, në të cilën ndër të tjera citohet si më poshtë vijon:

“..[.Bazuar në Vendimin nr 693/2025 me Nr 1172/11 prot , datë 26.05.2025 me objekt “Ekspertizë teknike e posaçme, për përllogaritjen në vlerën minimale dhe maksimale të fondit limit për procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike” me nr. REF -44148-04-08- 2025, me objekt: “Mbikëqyrje punimesh për objektin: “Ndërtimi montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”, me fond limit 1.249.423,86 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 22.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a, parapes raportin tim të ekspertizës si më poshtë vijon :

I. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Objekti:	<i>“Ndërtimi montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”</i>
Enti Prokurues	<i>Albpetrol sh.a</i>
Operatori ekonomik:	<i>Operatori ekonomik “C.E.C GROUP” SHPK, me NIPT L11807013M dhe adresë Njësia bashkiake nr 7 Rruga Dritan Hoxha Ndërtesa nr 117, Shkalla nr 2, Apartamenti nr. 5/3 Tiranë.</i>
Vlera e prokurimit:	<i>1.249.423,86 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë (pa tvsh)</i>
Burimi i financimit:	<i>Buxheti i Shtetit</i>
Data e ekspertimit:	<i>16/ 06/ 2025</i>

II. QËLLIMI I EKSPERTIMIT

Ky raport ka për qëllim përcaktimin e vlerës financiare të shërbimit të supervizimit teknik për objektin “Ndërtim montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”, në përputhje me normativat teknike dhe VKM nr. 354, datë 11.05.2016. Në bazë të kërkesës të bërë nga Komisioni i prokurimit publik me shkresën nr 1172/14 datë 29.05.2025 “Pyetje drejtuar ekspertit” kerkohet të jepet përgjigje për dy çështje.

1.A është përlllogaritur fondi limit për procedurën e prokurimit objekt ankimimi nga autoriteti kontraktor në përputhje me VKM 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim , mbikëqyrje dhe koaludim?

2, Sa është kufiri minimal dhe maksimal i shërbimit të supervizimit për procedurën e prokurimit “Ndërtimi montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”, referuar VKM 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territory, projektim , mbikëqyrje dhe koaludim.

II. BAZA LIGJORE

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik VKM nr. 354, datë 11.05.2016.

III. METODOLOGJIA E PËRDORUR

Për përcaktimin e vlerës së supervizimit teknik të punimeve është marrë për bazë:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe manuali përkatës, i cili përcakton nivelin në përqindje të tarifave për shërbimet e mbikëqyrjes, në varësi të vlerës së ndërtimit të objektit.

Nga ana e autoritetit kontraktor llogaritja e vlerës limit të prokurimit për shërbimin e supervizimit është kryer sipas metodologjisë së mëposhtme

- 1. Objekti është ndarë në tre grupe Depo 400 m³, Depo 100 m³ dhe Depo 200 m³.*

2. Secili grup i përzgjedhur në bazë të referencës së analizës të çmimeve është ndarë në 3 nëngrupe
 - a. Punime ndërtimi referuar analizave të çmimit të Manualit nr. 2 të çmimeve të miratuara në vitin 2023
 - b. Punime infrastrukturë rrugore referuar analizave të çmimeve të Manualit nr 3 të çmimeve të miratuara në vitin 2023
 - c. Punime sisteme teknike referuar analizave të çmimeve të Manualit nr 4 të çmimeve të miratuara në vitin 2023
3. Sipas vlerave të percaktuara si vlera ndërtimore për çdo nëngrup në grupet kryesore janë percaktuar vlerat minimale dhe maksimale të supervizimit dhe vlera totale limit e supervizimit është nxjerrë si shumatore e këtyre nënvlerave.
4. Gjatë grupimit të vlerave të ndara në punime ndërtimi, infrastrukturë dhe sisteme teknike vlerat totale në grupe të mëdha sipas llojit të depove janë të sakta ndërsa në nëndarjen e mëtejshme janë gabimet si më poshtë:
 - a. **Objekti RMV 400 m³**
 - Zëri Analiza teknike për punimet dhe Instalimet teknologjike me vlerë 3.306.320.16 lekë pa tvsh i cili i është referuar në analizë çmimi Manualit nr. 4, është vendosur gabim në kapitullin Punime ndërtimi (duhej llogaritur në Sistemet teknike)
 - Punime Shpyllëzimi me vlerë 1.331,40 referuar në Analizë manualit nr. 3 të çmimeve për punime infrastrukturë rrugore, është vendosur gabim në punime ndërtimi.
 - b. **Objekti RMV 100 m³**
 - Zëri Analiza teknike për punimet dhe Instalimet teknologjike me vlerë 465.053.04 lekë pa tvsh i cili i është referuar në analizë çmimi Manualit nr 4, është vendosur gabim në kapitullin Punime ndërtimi (duhej llogaritur në Sistemet teknike)
 - c. **Objektet RMV 200 m³ të ndara në 8 nënobjekte**
 - Sipas përshkrimit të zërave të punës të sqaruara nga Autoriteti kontraktor në shkresën nr 2753/1 datë 04.06.2025 “Kthim përgjigje” për objektet RMV 200 m³ nuk përputhen shifrat totale sipas grupimit të punimeve si më poshtë:
 - Punime ndërtimi vlera e ndërtimit e raportuar prej tyre është 14.507.468,82 lekë. Pas kryerjes së veprimeve për çdo zë të llogaritur prej tyre në punime ndërtimi vlera del 13.318.981,39 lekë
 - Punime infrastrukturë rrugore e raportuar prej tyre është 6.450.765.08 lekë. Pas kryerjes së veprimeve për çdo zë të llogaritur prej tyre në punime infrastrukturë rrugore vlera del 7.167.402,13 lekë
 - Punime sisteme teknike e raportuar prej tyre është 21.943.445,6 lekë. Pas kryerjes së veprimeve për çdo zë të llogaritur prej tyre në punime sisteme teknike vlera del 21.944.445,63 leke
5. Fondi rezerve i llogaritur është përfshirë i plotë në masën 3% të çdo objekti në Punime ndërtimi, ndërsa infrastruktura rrugore dhe sistemet teknike janë llogaritur pa fond rezervë. Në preventivin e objektit fondi rezervë është llogaritur për të gjitha zërat e

punimeve përjashtuar vetëm pajisjet. Kjo ka çuar në rritjen artificiale të zërave të punimeve të ndërtimit dhe në uljen e vlerave të punimeve të infrastrukturës rrugore dhe sistemeve teknike.

6. *Ndarja e punimeve në tre grupe të mëdha dhe ndarja e çdo grupi në tre nëngrupe ka çuar në rritje artificiale të vlerës limit të supervizimit, pasi referuar tabelave me rritjen e vlerës ulet koeficienti përlllogaritës.*
7. *Nga ana e operatorëve ekonomik është pothuajse e pamundur llogaritja e vlerës minimum dhe maksimum e supervizimit pa dhënë orientime të mëtejshme enti prokurues pasi gjatë përgatitjes së ofertës asnjë operator ekonomik nuk ka në dorë preventivin e projektuesit për të bërë ndarjen e punimeve. Operatorit në dokumentat e prokurimit i është dhënë vlera totale limit dhe tarifat ky është mbështetur autoriteti kontraktor për llogaritjen e vlerës limit pa specifikuar se sa përqind të punimeve zënë punimet e ndërtimit, infrastruktura rrugore dhe sistemet teknike. Kjo gje ka bërë që vlerat e ofruar nga operatorët ekonomik të jenë nën vlerën minimum të llogaritur nga Enti prokurues.*
8. *Më poshtë po ju paraqes në mënyrë analitike llogaritjet e kryera në metodologjinë e punës të bërë nga Enti prokurues duke pasqyruar vetëm ndryshimet për gabimet aritmetike të bëra prej tyre.*

VARIANTI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Punime ndertimi	RMV 400	RMV 100 m3	RMV 200 m3	Totali
Analiza teknike per punimet dhe Instalmet teknologjike (Manuali nr 4 duhet tek sistemet teknike)	3,306,320.16	465,053.04	11,966,924.00	15,738,297.20
Punime shtresash (Manuali nr 2)	293,174.86			293,174.86
Punime shpyllezimi (Manuali nr 3)	1,331.40			1,331.40
Punime dheu (Manuali 2)	43,140.28			43,140.28
Nenshtresa dhe shtresa ne territorin e ndertesave (Manuali nr 2)	32,928.72			32,928.72
Punime hekurbetoni (Manuali nr 2)	192,760.52			192,760.52
Punime hidroizolimi e catie (Manuali nr 2)	771,625.57			771,625.57
Punime dyer dritare (Manuali nr 2)	42,466.38			42,466.38
Punime bojatisje		7,263.00	116,208.00	123,471.00
Instalime ndricimi (Manuali nr 2)	7,046.30			7,046.30
Punime betoni e betonarme (Manuali nr 2)	35,735.40			35,735.40
Shuma	4,726,529.59	472,316.04	12,083,132.00	17,281,977.63
Fond rezerve 3 %	379,966.34	101,883.48	1,235,849.39	1,717,699.21
Shuma me fond rezervë	5,106,495.93	574,199.52	13,318,981.39	18,999,676.84
				-
Struktura transporti				-
Punime germimi (Manuali 3)		110,041.06	605,935.84	715,976.90
Punime dheu (Manuali 2)			107,049.60	107,049.60
Punime shtresash (Manuali nr 3)		467,554.26	2,903,687.42	3,371,241.68
Punime betoni e betonarme (Manuali nr 3)		45,629.46	1,198,879.11	1,244,508.57
Analiza teknike (Manuali nr 3)		56,607.14	1,051,976.16	1,108,583.30
Punime shpyllezimi (Manuali nr 3)		4,082.97	9,231.12	13,314.09
Punime hekurbetoni (Manuali nr 3)			1,290,642.88	1,290,642.88

Ujesjelles kanalizime (Manuali nr 2)		91,453.31		91,453.31
Shuma		775,368.20	7,167,402.13	7,942,770.33
Sisteme teknike				-
Gaz dhe naftesjelles	2,552,602.06	636,155.74	4,761,753.24	7,950,511.04
Analiza jashte liste	5,386,413.08	1,512,275.95	17,182,692.39	24,081,381.42
Pajisje jashte liste	452,000.00	-	470,850.00	922,850.00
Shuma	8,391,015.14	2,148,431.69	21,944,445.63	32,483,892.46
Shuma Punime ndërtimi + Struktura				-
transporti + Sisteme teknike	12,665,544.73	3,396,115.93	41,194,979.76	57,256,640.42
Fond rezerve 3 %	379,966.34	101,883.48	1,235,849.39	1,717,699.21
Shuma	13,045,511.07	3,497,999.41	42,430,829.15	58,974,339.63
Pajisje jashte liste	452,000.00	-	470,850.00	922,850.00
Shuma	13,497,511.07	3,497,999.41	42,901,679.15	59,897,189.63

Në mënyrë të detajuar për Depo 200 m³ llogaritjet nga autoriteti kontraktor janë si më poshtë:

	Stacioni Zharres QPN Fier	Impianti Injektimit Gorisht	Sektori Gorisht QPN Gorisht	Gr nr 2 Sektori Gorisht QPN Gorisht	Gr 11 Sektori Kocul QPN Gorisht	Gr 14 Sektori Kocul QPN Gorisht	Gr 9 Sektori 3 Kocul QPN Gorisht	Stacioni 06 QPN Fier	Totali
RMV 200 m3									
PUNIME NDERTIMI									
Analiza teknike per punimet dhe Instalimet teknologjike (Manuali nr 4 duhet tek sistemet teknike)	2230794.20	1,425,142.06	1,425,142.06	1,425,142.06	1,425,142.06	1,425,142.06	1,425,142.06	1,185,277.44	11,966,924.00
Punime bojatisje	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	116,208.00
Shuma	2245320.20	1439668.06	1439668.06	1439668.06	1439668.06	1439668.06	1439668.06	1199803.44	12,083,132.00
Fond rezerve 3%	217147.52	145,526.08	145,526.08	145,526.08	145,526.08	145,526.08	145,526.08	145,545.39	1,235,849.39
Shuma	2462467.72	1585194.14	1585194.14	1585194.14	1585194.14	1585194.14	1585194.14	1345348.83	13,318,981.39
Struktura transporti									
Punime germimi (Manuali 3)	77158.00	77,158.68	77,158.68	77,158.69	77,158.68	77,158.68	77,158.69	65,825.74	605,935.84
Punime dheu (Manuali 2)	15292.80	15,292.80	15,292.80	15,292.80	15,292.80	15,292.80	15,292.80		107,049.60
Punime shtresash (Manuali nr 3)	383639.80	383,639.80	383,639.80	383,639.80	383,639.80	383,639.80	383,639.80	218,208.82	2,903,687.42
Punime betoni e betonarme (Manuali nr 3)	202698.82	155,165.89	155,165.89	155,165.89	155,165.89	155,165.89	155,165.89	65,184.95	1,198,879.11
Analiza teknike (Manuali nr 3)	135302.40	135,302.40	135,302.40	135,302.40	135,302.40	135,302.40	135,302.40	104,859.36	1,051,976.16
Punime shpyllezimi (Manuali nr 3)	1153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	9,231.12
Punime hekurbetoni (Manuali nr 3)	360365.80	155,046.18	155,046.18	155,046.18	155,046.18	155,046.18	155,046.18		1,290,642.88
Shuma	1,175,611.51	922,759.64	922,759.64	922,759.65	922,759.64	922,759.64	922,759.65	455,232.76	7,167,402.13
Sisteme teknike									
Gaz dhe naftesjelles	673085.96	586,078.70	586,078.70	586,078.70	586,078.70	586,078.70	586,078.70	572,195.08	4,761,753.24
Analiza jashte liste	3144232.25	1,902,363.09	1,902,363.09	1,902,363.09	1,902,363.09	1,902,363.09	1,902,363.09	2,624,281.60	17,182,692.39
Pajisje jashte liste	470850.00								470,850.00
Shuma	3,817,318.21	2,488,441.79	2,488,441.79	2,488,441.79	2,488,441.79	2,488,441.79	2,488,441.79	3,196,476.68	21,944,445.63
Shuma	7,455,397.44	4,996,395.57	4,996,395.57	4,996,395.58	4,996,395.57	4,996,395.57	4,996,395.58	4,997,058.27	42,430,829.15
Pajisje jashte liste	470850.00								470,850.00
Shuma me pajisje pa tvsh									42,901,679.15

LLOGARITAJ E VLERES SE PUNIMEVE SIPAS EKSPERTIT

A. Varianti sipas metodologjise te perzgjedhur nga Enti Prokurues

Ne llogaritjen që kam kryer për vlerën e punimeve i jam referuar metodologjisë së përdorur nga autoriteti kontraktor du ke bere në vlerën totale të objektit grupimet e punimeve sipa references te analizes se cmimeve si më poshtë

1. Çmimet e referuara Manualit nr 2 Punime ndërtimi
2. Çmimet e referuara Manualit nr 3 Struktura Transporti

3. Çmimet e referuara Manualit nr 4 Sisteme teknike

Fondi rezervë është llogaritur për cdo grup punimesh

Punime ndertimi	RMV 400	RMV 100 m3	RMV 200 m3	Totali
Punime shtresash	293,174.86			293,174.86
Punime dheu (Manuali 2)	43,140.28		107,049.60	150,189.88
Punime shtresash (Manuali nr 2)	32,928.72			32,928.72
Punime hekurbetoni	192,760.52			192,760.52
Punime hidroizolimi e catie	771,625.57			771,625.57
Punime dyer dritare	42,466.38			42,466.38
Punime bojatisje		7,263.00	116,208.00	123,471.00
Ujesjelles kanalizime (Manuali nr 2)		91,453.31		91,453.31
Instalime ndricimi	7,046.30			7,046.30
Punime betoni e betonarme (Manuali nr 2)	35,735.40			35,735.40
Shuma	1,418,878.03	98,716.31	223,257.60	1,740,851.94
Fond rezerve 3 %	42,566.34	2,961.49	6,697.73	52,225.56
Shuma	1,461,444.37	101,677.80	229,955.33	1,793,077.50
Struktura transporti				-
Punime germimi (Manuali 3)		110,041.06	605,935.84	715,976.90
Punime shtresash (Manuali nr 3)		467,554.26	2,903,687.42	3,371,241.68
Punime shpyllezimi (Manuali nr 3)	1,331.40			1,331.40
Punime betoni e betonarme (Manuali nr 3)		45,629.46	1,198,879.11	1,244,508.57
Analiza teknike (Manuali nr 3)		56,607.14	1,051,976.16	1,108,583.30
Punime shpyllezimi (Manuali nr 3)		4,082.97	9,231.12	13,314.09
Punime hekurbetoni (Manuali nr 3)			1,290,642.88	1,290,642.88
Shuma	1,331.40	683,914.89	7,060,352.53	7,745,598.82
Fond rezerve 3 %	39.94	20,517.45	211,810.58	232,367.96
Shuma	1,371.34	704,432.34	7,272,163.11	7,977,966.78
Sisteme teknike				-
Gaz dhe naftesjelles	2,552,602.06	636,155.74	4,761,753.24	7,950,511.04
Analiza teknike per punimet dhe Instalmet teknologjike (Manuali nr 4 duhet tek sistemet teknike)	3,306,320.16	465,053.04	11,966,924.00	15,738,297.20
Analiza jashte liste	5,386,413.08	1,512,275.95	17,182,692.39	24,081,381.42
Pajisje jashte liste	452,000.00	-	470,850.00	922,850.00
Shuma pa Pajisje	11,245,335.30	2,613,484.73	33,911,369.63	47,770,189.66
Fond rezerve 3 %	337,360.06	78,404.54	1,017,341.09	1,433,105.69
Shuma me fond rezerve pa pajisje	11,582,695.36	2,691,889.27	34,928,710.72	49,203,295.35
Totali me pajisje pa tvsh	13,045,511.07	3,497,999.41	35,399,560.72	50,126,145.35
Totali RMV 200 m³	13.497.511,07	3.497.999.41	42.901.679.15	59.897.189.63

Për punimet ne RMV 200 m³ llogaritja analitike është si më poshtë:

	Stacioni Zharres QPN Fier	Impianti Injektimit Gorisht	Sektori Gorisht QPN Gorisht	Gr nr 2 Sektori Gorisht QPN Gorisht	Gr 11 Sektori Kocul QPN Gorisht	Gr 14 Sektori Kocul QPN Gorisht	Gr 9 Sektori 3 Kocul QPN Gorisht	Stacioni 06 QPN Fier	Totali
RMV 200 m3									
PUNIME NDERTIMI									
Punime dheu (Manuali 2)	15,292.80	15,292.80	15,292.80	15,292.80	15,292.80	15,292.80	15,292.80		107,049.60
Punime bojatisje	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	116,208.00
Shuma	29,818.80	29,818.80	29,818.80	29,818.80	29,818.80	29,818.80	29,818.80	14,526.00	223,257.60
Fond rezerve 3%	894.56	894.56	894.56	894.56	894.56	894.56	894.56	435.78	6,697.73
Shuma	30,713.36	30,713.36	30,713.36	30,713.36	30,713.36	30,713.36	30,713.36	14,961.78	229,955.33
Struktura transporti									
Punime germimi (Manuali 3)	77,158.00	77,158.68	77,158.68	77,158.69	77,158.68	77,158.68	77,158.69	65,825.74	605,935.84
Punime shtresash (Manuali nr 3)	383,639.80	383,639.80	383,639.80	383,639.80	383,639.80	383,639.80	383,639.80	218,208.82	2,903,687.42
Punime betoni e betonarme (Manuali nr 3)	202,698.82	155,165.89	155,165.89	155,165.89	155,165.89	155,165.89	155,165.89	65,184.95	1,198,879.11
Analiza teknike (Manuali nr 3)	135,302.40	135,302.40	135,302.40	135,302.40	135,302.40	135,302.40	135,302.40	104,859.36	1,051,976.16
Punime shpyllezimi (Manuali nr 3)	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	9,231.12
Punime hekurbetoni (Manuali nr 3)	360,365.80	155,046.18	155,046.18	155,046.18	155,046.18	155,046.18	155,046.18		1,290,642.88
Shuma	1,160,318.71	907,466.84	907,466.84	907,466.85	907,466.84	907,466.84	907,466.85	455,232.76	7,060,352.53
Fond rezerve 3%	34809.56	27224.01	27224.01	27224.01	27224.01	27224.01	27224.01	13656.98	211,810.58
Shuma	1,195,128.27	934,690.85	934,690.85	934,690.86	934,690.85	934,690.85	934,690.86	468,889.74	7,272,163.11
Sisteme teknike									
Analiza teknike per punimet dhe Instalmet teknologjike (Manuali nr 4 duhet tek sistemet teknike)	2,230,794.20	1,425,142.06	1,425,142.06	1,425,142.06	1,425,142.06	1,425,142.06	1,425,142.06	1,185,277.44	11,966,924.00
Gaz dhe naftesjelles	673,085.96	586,078.70	586,078.70	586,078.70	586,078.70	586,078.70	586,078.70	572,195.08	4,761,753.24
Analiza jashte liste	3,144,232.25	1,902,363.09	1,902,363.09	1,902,363.09	1,902,363.09	1,902,363.09	1,902,363.09	2,624,281.60	17,182,692.39
Pajisje jashte liste	470,850.00								470,850.00
Shuma	6,048,112.41	3,913,583.85	3,913,583.85	3,913,583.85	3,913,583.85	3,913,583.85	3,913,583.85	4,381,754.12	33,911,369.63
Fond rezerve 3%	181,443.37	117,407.52	117,407.52	117,407.52	117,407.52	117,407.52	117,407.52	131,452.62	1,017,341.09
Shuma	6,229,555.78	4,030,991.37	4,030,991.37	4,030,991.37	4,030,991.37	4,030,991.37	4,030,991.37	4,513,206.74	34,928,710.72
Shuma me Pajisje pa tvsh	6,700,405.78	4,030,991.37	4,030,991.37	4,030,991.37	4,030,991.37	4,030,991.37	4,030,991.37	4,513,206.74	35,399,560.72
Totali	7,926,247.42	4,996,395.57	4,996,395.57	4,996,395.59	4,996,395.57	4,996,395.57	4,996,395.59	4,997,058.27	42,901,679.15

B. Varianti I përlllogaritjes sipas vlerës së plotë të objektit

Ky është varuanti është më i saktë i vlerës supervizimit duke përjashtuar çdo lloj abuzimi të operatorëve ekonomik për të marrë nga Enti prokurues preventivin e projektit apo mënyrën e llogaritjes së fondit limit të supervizimit të objektit.

Vlera e supervizimit llogaritet për vlerën e plotë të objektit duke marrë në konsideratë përqindjen më të madhe të punimeve të parashikuar në preventivin e projektit. Pra vlera e supervizimit duhet ti referohej në mënyrë të plotë vlerës së objektit 59.897.189.63 lekë dhe duke e trajtuar në grupin e tretë tarifor për këto sisteme.

LLOGARITJA E VLERËS SË SUPERVIZIMIT NË BAZË TË VKM NR 354 DATË 11.05.2016 “PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIMIN E TERRITORIT, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM METODOLOGJIA E PËRDORUR

Për përcaktimin e vlerës së supervizimit teknik të punimeve është marrë për bazë:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe manuali përkatës, i cili përcakton nivelin në përqindje të tarifave për shërbimet e mbikëqyrjes, në varësi të vlerës së ndërtimit të objektit.

Hapat për llogaritjen e vlerës së mbikëqyrjes:

1. **Përcaktimi i kategorisë së objektit:** Kategoria e objektit këtu duhej të ishte trajtuar si Sisteme teknike pasi vlera e punimeve të ndërtimit dhe të strukturës rrugore është e vogël kundrejt vlerës totale të objektit (punimet e ndërtimit në masën 3% të totalit të punimeve dhe punimet e strukturës rrugore në masën 13 % të totalit të punimeve).
2. **Gjetja e përqindjeve për mbikëqyrje:** Në manualin e tarifave, për veprat inxhinierike janë përcaktuar përqindjet minimale dhe maksimale për shërbimin e mbikëqyrjes. Këto përqindje aplikohen mbi vlerën e ndërtimit të objektit për të llogaritur vlerën e mbikëqyrjes.
3. **Llogaritja e vlerës së mbikëqyrjes:** Pasi janë përcaktuar përqindjet përkatëse, shumëzohen këto përqindje me vlerën totale të ndërtimit të veprës për të marrë vlerën minimale dhe maksimale të mbikëqyrjes.

Ne bazë të VKM nr 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim, Shtojca nr 1, llogaritja e koeficientit minimum dhe maksimum behet sipas metodologjise së mëposhtme:

Në rast se kostoja e llogaritëshme ($X = \text{vlera e preventivit}$), është një vlerë e cila nuk gjendet në tabelë atëherë do të përdorimin formulën e interpolimit për të gjetur tarifën, e cila do të llogaritet si më poshtë:

Në fillim do të gjejmë në tabelë kostot e llogaritëshme, mes të cilave ndodhet kostoja e llogaritëshme (X) për të cilën duam të llogarisim tarifën. Kostoja e llogaritëshme $K1$ me vlerë minimale (a) vlerë maksimale (b) Kostoja e llogaritëshme $K2$ me vlerë minimale (c) vlerë maksimale (d)

Llogarisim koston minimale/maksimale mes vlerave a dhe b sipas formulës: $H1 = a + (0 \div 1) \times (b - a)$

Llogarisim koston minimale/maksimale mes vlerave c dhe d sipas formulës: $H2 = c + (0 \div 1) \times (d - c)$

Llogarisim diferencën e kostove të llogaritëshme reale $X - K1 = D1$

Llogarisim diferencën mes dy kostove $K2 - K1 = D2$

Llogarisim diferencën minimale/maksimale: $H2 \div H1 = D3 \text{ min}$ $H2 \div H1 = D3 \text{ max}$

Formula e interpolimit për tarifën minimale, do të jetë:

$$H1 + \frac{D3 \text{ min} \times D1}{D2}$$

$$a + 0 \times (b - a) + \frac{(c + 0 \times (d - c)) - [a + 0 \times (b - a)]}{K2 - K1} \times (X - K1) = \text{tarifa minimale}$$

Formula e interpolimit për tarifën maksimale do të jetë

$$H1 + \frac{D3 \text{ max} \times D1}{D2}$$

$$a + 1 \times (b - a) + \frac{(c + 1 \times (d - c)) - [a + 1 \times (b - a)]}{K2 - K1} \times (X - K1) = \text{tarifa maksimale}$$

Për vlerat e punimeve që janë nën vlerën minimale të përcaktuar në tabelat e përlllogaritjes së koeficientëve llogaritja bëhet si më poshtë:

Duke qenë se vlera e objektit është më e vogël se kufiri më i ulët i përcaktuar në tabelën përkatëse të manualit, është zbatuar përcaktimi në VKM nr. 354, datë 11.05.2016:

“Nëse kostot e llogaritshme të identifikuara qëndrojnë jashtë vlerave tabelare të këtij manuali, tarifat sipas rastit janë më të larta apo më të ulëta të llojit apo grupit tarifor përkatës të shërbimit, duke përdorur koeficientin e ndryshimit përkatës në mënyrë zbritëse apo rritëse.”

Llogaritet koeficienti rritës meqënesë vlera është më e vogël se vlera minimale e përcaktuar në tabelë

IV. LLOGARITJA E VLERËS SË SUPERVIZIMIT

Vlera minimale e supervizimit = vlerën minimale të projektimit shumëzuar me përqindjen e supervizimit sipas llojit të punimeve dhe grupit ku përfshihet objekti

Diferenca e koeficientit nga vlera minimum e objektit në tabele $\Delta k = (b - a) / K$

a- koeficienti minimal per vlerën minimale të përcaktuar në tabele

b- koeficienti maksimal nga vlera minimum e objektit në tabele

k- Vlera minimale e kushtimit të veprës e përcaktuar në tabelë

llogaritet $D = X - K$ ku

X është vlera jone

K vlera minimale në tabele

D- diferenca ndërmjet vlerës minimale në tabelë dhe vlerës tonë

K është vlera minimale

*Rritja e koeficientit minimal është $D2 = D * \Delta k$*

Koeficienti minimal llogaritet $a + D2$

Koeficienti maksimal llogaritet $b + D2$

Në llogaritjen e vlerës së supervizimit ekzistojnë dy metoda

1. Metoda me interpolim në koeficient projektimi:

*Koeficienti minimal i interpoluar: Koeficienti minimal * % e përcaktuar për supervizim*

Tarifa minimale: Vlera e objektit x Koeficientit minimal

*Koeficienti maksimal i interpoluar: Koeficienti maksimal * % e përcaktuar për supervizim*

Tarifa maksimale: Vlera e Objektit x Koeficienti maksimal

2. Metoda me interpolim në vlera absolute:

Interpolimi është kryer direkt në vlerat e tarifës për kufijtë minimal dhe maksimal.

Tarifa minimale e interpoluar në lekë

Tarifa maksimale e interpoluar: në lekë

Koeficientët efektivë që rezultojnë nga këto vlera janë:

Minimal: Vlera minimale në raport me vlerën e objektit e nxjerre në %

Maksimal: Vlera maksimale në raport me vlerën e objektit e nxjerre në %

Vlerat minimale dhe maksimale shumëzohen me përqindjen e supervizimit

Në këtë përlllogaritje është aplikuar interpolimi linear në vlera absolute të tarifës për dy kufijtë e përcaktuar në VKM. Si pasojë, koeficienti efektiv që rezulton nga ndarja e tarifës së interpoluar me vlerën e objektit është pak më i ulët se ai që do të rezultonte nga interpolimi i drejtpërdrejtë i përqindjeve. Kjo diferencë është e natyrshme për shkak të karakterit jo-linear të përqindjes ndaj vlerës dhe është teknikisht e pranueshme për përdorim në përlllogaritje të thjeshtuara ose kur mungojnë koeficientët e saktë.

Në bazë të VKM 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” Shtojca 1 referuar Nenit nr 13 Interpolimi, ku thuhet: Në rast se kostoja e llogaritëshme (X = vlera e preventivit), është një vlerë e cila nuk gjendet në tabelë atëherë do të përdorimin formulën e interpolimit për të gjetur tarifën, I kam llogaritur përqindjen e tarifës së supervizimit në të dy metodat dhe për vlerën e supervizimit i jam referuar Metodes se dyte, pasi metodat e mësipërme kanë devijime ndermjet njera tjetres që ndikon në përcaktimin e saktë të vlerës minimale të supervizimit. Meqënëse nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” i referohet vlerës dhe une kam marrë për tarifë të saktë tarifën e bazuar në nxjerrjen e vlerave maksimum dhe minimum.

Në bazë të metodologjisë së mësipërme Llogaritja e supervizimit sipas entit kontraktor e korrigjuar del si me poshtë:

**Llogaritja sipas entit
kontraktor**

	RVM 400 m3	RVM 100 m3	RVM 200 m3	Totali
Punime ndertimi	5,106,495.93	574,199.52	13,318,981.39	18,999,676.84
Punime infrastrukture	-	775,368.20	7,167,402.13	7,942,770.33
Sisteme teknike	8,391,015.14	2,148,431.69	22,415,295.63	32,954,742.46
Shuma	13,497,511.07	3,497,999.41	42,901,679.15	59,897,189.63

Grupi V per ndertesat
Grupi III tarifar Strukture
transporti

Grupi III tarifar per
sistemet teknike

**Vlera minimum
supervizimi**

	RVM 400 m3	RVM 100 m3	RVM 200 m3	Totali
Punime ndertimi	88,770.43	10,091.56	221,520.73	320,382.72
Punime infrastrukture	-	17,348.86	136,735.26	154,084.12
Sisteme teknike	147,511.40	66,434.53	397,691.05	611,636.99
Shuma Vlera minimum	236,281.83	78,210.61	755,947.04	1,070,439.48

**Vlera maksimum
supervizimi**

	RVM 400 m3	RVM 100 m3	RVM 200 m3	Totali
Punime ndertimi	97,331.09	11,887.24	242,678.95	351,897.28
Punime infrastrukture	-	23,280.43	159,292.35	182,572.78
Sisteme teknike	231,771.85	78,626.15	467,105.39	777,503.40
Shuma Vlera maksimum	329,102.94	113,793.82	869,076.70	1,311,973.46

Sipas metodologjise së entit kontraktor duke bërë sistemimet e punimeve në bazë të analizave të përdorura llogaritja e vleres maksimale dhe minimale të supervizimit sipas llogaritjet të kryer nga Eksperti del si me poshtë:

Llogaritja e supervizimit	Vlera	Min Supervizim	Max Superviz
Punime ndertimi	1,793,077.50	31,513.34	34,561.57
Punime infrastrukture	7,977,966.78	148042.64	171946.92
Sisteme teknike	50,126,145.35	741994.84	850872.28
Total	59,897,189.63	921,550.81	1,057,380.77

Në bazë të përlllogaritjes se vleres se supervizimit duke e marrë si objekt të vetëm vlera minimale dhe maksimale e supervizimit del si me poshte:

Llogaritja si objekt I vetem Sisteme teknike

Vlera e objektit	Totali	Vlera min supervizimi	Vlera max supervizimi
Objekti ne total	59,897,189.63	866,715.62	992,880.16

Ne mënyrë analitike llogaritjet jane sipas tabelave në excel bashkelidhur

V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në përputhje me VKM nr. 354, datë 11.05.2016 dhe në bazë të llogaritjes sipas përqindjeve progresive për vlerat ndërmjetëse, vlera minimale e supervizimit teknik për objektin me vlerë ndërtimi 59,897,189.63 lekë pa tvsh është:

Nga Enti Prokurues Vlera minimum dhe vlera limit e supervizimit pas korrigjimeve të vlerave pjesore të objekteve nga ana aritmetike duhej të ishte:

1,070,439.48 (një milion e shtatëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë nëntë pikë dyzet e tetë) lekë, pa TVSH.

Vlera limit e supervizimit 1,311,973.46 (një milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre pikë dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në bazë të përlllogaritjes së mësipërme Autoriteti kontraktor ka devijim të llogaritjes si nga vlera limit e supervizimit ashtu dhe për llogaritjen e vlerës minimum të supervizimit për dy arsye:

- Coptimit të fondit të ndërtimit në tre grupe dhe për çdo grup në tre nëngrupe gjë që con në rritje artificiale të vlerës së supervizimit**
- Gabimeve aritmetike të kryera Brenda nen grupeve në objektin RVM 200 m³**

Kjo ka bërë që operatorët ekonomikë të konkurojnë nën vlerën minimum të përcaktuar nga Enti prokurues pasi nuk kanë pasur të qartë kërkesës e Entit prokurues nëse duhet të konkurojnë kundrejt vlerës totale të objektit apo kundrejt grupimit të punimeve sipas manualit.

Në bazë të grupimit të punimeve sipas llojit të tyre të ndara vetëm në tre grupe për të gjitha llojet e punimeve sipas RVM vlera minimum e supervizimit dhe vlera limit e supervizimit paraqitet si më poshtë:

Llogaritja e supervizimit	Vlera	Min Supervizim	Max Superviz
---------------------------	-------	----------------	--------------

Punime ndertimi	1,793,077.50	31,513.34	34,561.57	Grupi V per ndertesat Grupi III tarifar Strukture transporti Grupi III tarifar per sistemet teknike
Punime infrastrukture	7,977,966.78	148042.64	171946.92	
Sisteme teknike	50,126,145.35	741994.84	850872.28	
Total	59,897,189.63	921,550.81	1,057,380.77	

Në mënyrë të saktë Vlera limit e supervizimit dhe vlera limit e supervizimit duhej të llogariteshin mbështetur në vlerën e plotë të projektit pasi punimet civile dhe të infrastruktures rrugore nuk kanë vlerë të konsiderueshme referuar vlerës totale të objektit.

Nëse do ishin mbështetur në këtë llogjikë vlera limit e supervizimit dhe vlera minimum do të ishte si më poshtë:

Vlera e objektit	Totali	Vlera min supervizimi	Vlera max supervizimi
Objekti në total	59,897,189.63	866,715.62	992,880.16

Konkluzion

*Oferta e ofruar nga Operatori Ekonomik C.E.C GROUP prej 1.086.998,76 lekë; nuk është vlerë anomalisht e ulët në asnjë rast të llogaritjes së vlerës minimum të supervizimit sipas tabelave të përshkruara më sipër pasi vlera minimale që duhej të kishte Enti prokurues sipas metodologjisë të përdorur prej tij duke I bërë vetëm korrigjimet aritmetike te vlerave te RVM 200 m3 del **1,070,439.48 lekë**.*

Në përgjigje të pyetjeve drejtuar ekspertit me shkresën e Komisionit të prokurimit publik Nr 1172/14 prot. datë 29.05.2025 “Pyetje drejtuar ekspertit” përgjigjet janë si më poshtë:

- 1. A është përlllogaritur fondi limit për procedurën e prokurimit objekt ankimi nga autoritetit kontraktor në përputhje me VKM nr. 354 , datë 11.05.2016*

Nga sa kam sqaruar më lart llogaritja e vlerës limit nga ana e autoritetit kontraktor është kryer gabim dhe ka deformim të vlerës limit të objektit, për efekt të copëtimit të fondeve në grupe dhe nën grupe që ka sjellë rritje të vlerës së objektit. Dhe në pyetjet për sqarim që i kemi dërguar Autoritetit kontraktor për këtë copim të fondeve, nuk kemi marrë përgjigje.

- 2. Sa është kufiri minimal dhe maksimal i shërbimit të supervizimit për procedurën e prokurimit “Ndërtim Montim i disa RVM-ve në Qëndrat e Albpetrol sh.a me fond l;imit 59.897.190 lekë pa tvsh, referuar VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.*

Në bazë të metodologjisë së përdorur nga Enti prokurues duke kryer vetëm korrigjimet aritmetike tek RVM 200 m³. vlera minimum duhet të ishte 1,070,439.48 lekë pa tvsh dhe vlera limit duhet të ishte 1,311,973.46 lekë pa tvsh.

Rekomandime

Nëse Enti Prokurues bën në ndarjen e punimeve në grupe sipas llojit të tyre duhet të orientojë operatorët ekonomikë minimum në përqindjen që zë secili prej tyre kundrejt punimeve në total të objektit.

II.26. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, i ndryshuar, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “C.E.C. GROUP” SHPK mbi skualifikimin e tij nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave me argumentimin se: “Oferta ekonomike e paraqitur nga Operatori Ekonomik nuk rezulton brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar, kjo ne kundërshtim me nenin 7, pika 1, Përcaktimi i tarifave, të VKM Nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, kerkese kjo bazuar dhe në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.5585 Prot datë 25.07.2017 “Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara ne Vendimin e këshillit të ministrave nr.354 datë 11.05.2016”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik, për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me vendimin e ndërmjetëm nr. 693/2025 datë 26.05.2025, vendosi të thërrasë ekspertin e fushës, për të verifikuar nëse përlllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi është bërë konform bazës ligjore të përcaktuar, e më konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 354 datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

III.1.2. Me shkresën nr. 1172/14 prot., datë 29.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik i ka dërguar ekspertës Znj.A.T, pyetjet që shtrohen për zgjidhje nga ana e saj, lidhur me procedurën e prokurimit objekt - ankimi. Konkretisht ekspertës i janë parashtruar këto pyetje:

1. *A është përllogaritur fondi limit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi nga autoriteti kontraktor në përputhje me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”?*
2. *Sa është kufiri minimal dhe maksimal i shërbimit të supervizimit për procedurën e prokurimit “Ndërtim-montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A” me fond limit 59 897 190 lekë pa tvsh, referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” ?*

Vlerat e llogaritura për kufijte minimalë dhe maksimalë të shërbimit të supervizimit të jepen me dy shifra pas presjes. Gjithashtu, bashkëngjitur po ju vëmë në dispozicion edhe dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e akt ekspertimit lidhur me këtë procedurë prokurimi.

III.1.3. Në zbatim të vendimit nr. 693/2025, datë 26.05.2025 të KPP-së, me dokumentin e datës 16.06.2025, me objekt “Raport ekspertimi” protokolluar me tonën me nr.1172/18 prot., datë 16.06.2025, ekspertia ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, raportin e nënshkruar lidhur me procedurën objekt - ankimi.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) *të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) *të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) *të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) *të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) *të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) *të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim*

të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe

të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.7. Komisioni konstaton, se pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues "C.E.C. GROUP" SHPK kanë të bëjnë përkatësisht me vlerën minimale të lejuar, të përlllogaritur nga ankimuesi bazuar në VKM nr. 354, datë 11.05.2016 "*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*", kërkon rivlerësim të ofertave dhe vlefshmërinë e ofertës së tij.

Për një shqyrtim sa më të drejtë dhe transparent të pretendimeve të palës ankimese, KPP gjykoj të nevojshme, të thërrasë ekspertin e fushës, për të verifikuar nëse përlllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt – ankimi është bërë konform bazës ligjore të përcaktuar, e më konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 354 datë 11.05.2016, "*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*", si dhe të përlllogarisë kufirin minimal dhe maksimal të shërbimit të supervizimit, për procedurën e prokurimit "*Ndërtim-montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A*", me fond limit 59,897,190 lekë pa TVSh, referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 "*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*". Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 11.05.2016 "*Për miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*", si dhe manuali

përkatës, i cili përcakton nivelin në përqindje të tarifave për shërbimet e mbikëqyrjes, në varësi të vlerës së ndërtimit të objektit.

Referur dokumentacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor me shkresën përcjellëse me nr. 2418/1 prot, datë 19.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1172/9 prot., datë 22.05.2025, ku autoriteti kontraktor ka dhënë informacion të detajuar mbi procesverbalin e përlllogaritjes së fondit limit të projektit të zbatimit me objekt “Ndërtim-montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”, referuar të cilit autoriteti kontraktor ka përlllogaritur fondin limit të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike”, me nr. REF-44148-04-08-2025, me objekt: “Mbikëqyrje punimesh për objektin: Ndërtim-montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”, me fond limit: 1,249,423.86 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH”. Nga ky dokument rezulton se:

“[...] Në përputhje me VKM nr. 354, datë 11.05.2016 dhe në bazë të llogaritjes sipas përqindjeve progresive për vlerat ndërmjetëse, vlera minimale dhe maksimale e supervizimit teknik për objektin me vlerë ndërtimi 59,897,190 lekë pa tvsh është:

Vlera maksimale: 1,249,423.86 lekë pa Tvsh

Vlera minimale: 1,091, 659.91 lekë pa Tvsh

Ndërsa, referuar “Raport ekspertizës” së ekspertes Znj.A.T, me shkresën e datës 16.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 1172/18 prot., datë 16.06.2025, ka rezultuar se :

“..[.]Bazuar në Vendimin nr 693/2025 me Nr 1172/11 prot , datë 26.05.2025 me objekt “Ekspertizë teknike e posaçme, për përlllogaritjen në vlerën minimale dhe maksimale të fondit limit për procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike” me nr. REF -44148-04-08- 2025, me objekt: “Mbikëqyrje punimesh për objektin: “Ndërtimi montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”, me fond limit 1.249.423,86 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 22.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a, parapjes raportin tim të ekspertizës si më poshtë vijon :

II. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Objekti:	<i>“Ndërtimi montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”</i>
Enti Prokurues	<i>Albpetrol sh.a</i>
Operatori ekonomik:	<i>Operatori ekonomik “C.E.C GROUP” SHPK, me NIPT L11807013M dhe adresë Njësia bashkiake nr 7 Rruga Dritan Hoxha Ndërtesa nr 117, Shkalla nr 2, Apartamenti nr. 5/3 Tiranë.</i>
Vlera e prokurimit:	<i>1.249.423,86 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë (pa tvsh)</i>
Burimi i financimit:	<i>Buxheti i Shtetit</i>
Data e ekspertimit:	<i>16/ 06/ 2025</i>

II. QËLLIMI I EKSPERTIMIT

Ky raport ka për qëllim përcaktimin e vlerës financiare të shërbimit të supervizimit teknik për objektin “Ndërtim montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”, në përputhje me normativat teknike dhe VKM nr. 354, datë 11.05.2016. Në bazë të kërkesës të bërë nga Komisioni i prokurimit publik me shkresën nr 1172/14 datë 29.05.2025 “Pyetje drejtuar ekspertit” kerkohet të jepet përgjigje për dy çështje.

1.A është përlllogaritur fondi limit për procedurën e prokurimit objekt ankimimi nga autoriteti kontraktor në përputhje me VKM 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim , mbikëqyrje dhe koaludim?

2, Sa është kufiri minimal dhe maksimal i shërbimit të supervizimit për procedurën e prokurimit “Ndërtimi montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”, referuar VKM 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territory, projektim , mbikëqyrje dhe koaludim.

II. BAZA LIGJORE

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik VKM nr. 354, datë 11.05.2016.

III. METODOLOGJIA E PËRDORUR

Për përcaktimin e vlerës së supervizimit teknik të punimeve është marrë për bazë:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe manuali përkatës, i cili përcakton nivelin në përqindje të tarifave për shërbimet e mbikëqyrjes, në varësi të vlerës së ndërtimit të objektit.

Nga ana e autoritetit kontraktor llogaritja e vlerës limit të prokurimit për shërbimin e supervizimit është kryer sipas metodologjisë së mëposhtme

9. Objekti është ndarë në tre grupe Depo 400 m³, Depo 100 m³ dhe Depo 200 m³.

10. Secili grup i përzgjedhur në bazë të referencës së analizës të çmimeve është ndarë në 3 nëngrupe

d. Punime ndërtimi referuar analizave të çmimit të Manualit nr. 2 të çmimeve të miratuara në vitin 2023

e. Punime infrastrukture rrugore referuar analizave të çmimeve të Manualit nr 3 të çmimeve të miratuara në vitin 2023

f. Punime sisteme teknike referuar analizave të çmimeve të Manualit nr 4 të çmimeve të miratuara në vitin 2023

11. Sipas vlerave të përcaktuara si vlera ndërtimore për çdo nëngrup në grupet kryesore janë përcaktuar vlerat minimale dhe maksimale të supervizimit dhe vlera totale limit e supervizimit është nxjerrë si shumatore e këtyre nënvlerave.

12. Gjatë grupimit të vlerave të ndara në punime ndërtimi, infrastrukture dhe sisteme teknike vlerat totale në grupe të mëdha sipas llojit të depove janë të sakta ndërsa në nëndarjen e mëtejshme janë gabimet si më poshtë:

d. Objekti RMV 400 m³

- Zëri Analiza teknike për punimet dhe Instalimet teknologjike me vlerë 3.306.320.16 lekë pa tvsh i cili i është referuar në analizë çmimi Manualit nr. 4, është vendosur gabim në kapitullin Punime ndërtimi (duhej llogaritur në Sistemet teknike)
- Punime Shpyllëzimi me vlerë 1.331,40 referuar ne Analizë manualit nr. 3 të çmimeve për punime infrastrukturë rrugore, është vendosur gabim në punime ndërtimi.

e. Objekti RMV 100 m³

- Zëri Analiza teknike për punimet dhe Instalimet teknologjike me vlerë 465.053.04 lekë pa tvsh i cili i është referuar në analizë çmimi Manualit nr. 4, është vendosur gabim në kapitullin Punime ndërtimi (duhej llogaritur në Sistemet teknike)

f. Objektet RMV 200 m³ të ndara në 8 nënobjekte

- Sipas përshkrimit të zërave të punës të sqaruara nga Autoriteti kontraktor në shkresën nr 2753/1 datë 04.06.2025 “Kthim përgjigje” për objektet RMV 200 m³ nuk përputhen shifrat totale sipas grupimit të punimeve si më poshtë:
- Punime ndërtimi vlera e ndërtimit e raportuar prej tyre është 14.507.468,82 lekë. Pas kryerjes së veprimeve për çdo zë të llogaritur prej tyre në punime ndërtimi vlera del 13.318.981,39 lekë
- Punime infrastrukturë rrugore e raportuar prej tyre është 6.450.765.08 lekë. Pas kryerjes së veprimeve për çdo zë të llogaritur prej tyre në punime infrastrukture rrugore vlera del 7.167.402,13 lekë
- Punime sisteme teknike e raportuar prej tyre është 21.943.445,6 lekë. Pas kryerjes së veprimeve për çdo zë të llogaritur prej tyre në punime sisteme teknike vlera del 21.944.445,63 leke

13. Fondi rezerve i llogaritur është përfshirë i plotë në masën 3% të çdo objekti në Punime ndërtimi, ndërsa infrastruktura rrugore dhe sistemet teknike janë llogaritur pa fond rezervë. Në preventivin e objektit fondi rezervë është llogaritur për të gjitha zërat e punimeve përjashtuar vetëm pajisjet. Kjo ka çuar në rritjen artificiale të zërave të punimeve të ndërtimit dhe në uljen e vlerave të punimeve të infrastrukturës rrugore dhe sistemeve teknike.

14. Ndarja e punimeve në tre grupe të mëdha dhe ndarja e çdo grupi në tre nëngrupe ka çuar në rritje artificiale të vlerës limit të supervizimit, pasi referuar tabelave me rritjen e vlerës ulet koeficienti përlllogaritës.

15. Nga ana e operatorëve ekonomik është pothuajse e pamundur llogaritja e vlerës minimum dhe maksimum e supervizimit pa dhënë orientime të mëtejshme enti prokurues pasi gjatë përgatitjes së ofertës asnjë operator ekonomik nuk ka në dorë preventivin e projektuesit për të bërë ndarjen e punimeve. Operatorit në dokumentat e prokurimit i është dhënë vlera totale limit dhe tarifat ky është mbështetur autoriteti kontraktor për

llogaritjen e vlerës limit pa specifikuar se sa përqind të punimeve zënë punimet e ndërtimit, infrastruktura rrugore dhe sistemet teknike. Kjo gje ka bërë që vlerat e ofruar nga operatorët ekonomik të jenë nën vlerën minimum të llogaritur nga Enti prokurues.

16. Më poshtë po ju paraqes në mënyrë analitike llogaritjet e kryera në metodologjinë e punës të bërë nga Enti prokurues duke pasqyruar vetëm ndryshimet për gabimet aritmetike të bëra prej tyre.

VARIANTI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Punime ndertimi	RMV 400	RMV 100 m3	RMV 200 m3	Totali
Analiza teknike per punimet dhe Instalmet teknologjike (Manuali nr 4 duhet tek sistemet teknike)	3,306,320.16	465,053.04	11,966,924.00	15,738,297.20
Punime shtresash (Manuali nr 2)	293,174.86			293,174.86
Punime shpyllezimi (Manuali nr 3)	1,331.40			1,331.40
Punime dheu (Manuali 2)	43,140.28			43,140.28
Nenshtresa dhe shtresa ne territorin e ndertesave (Manuali nr 2)	32,928.72			32,928.72
Punime hekurbetoni (Manuali nr 2)	192,760.52			192,760.52
Punime hidroizolimi e catie (Manuali nr 2)	771,625.57			771,625.57
Punime dyer dritare (Manuali nr 2)	42,466.38			42,466.38
Punime bojatisje		7,263.00	116,208.00	123,471.00
Instalime ndricimi (Manuali nr 2)	7,046.30			7,046.30
Punime betoni e betonarme (Manuali nr 2)	35,735.40			35,735.40
Shuma	4,726,529.59	472,316.04	12,083,132.00	17,281,977.63
Fond rezerve 3 %	379,966.34	101,883.48	1,235,849.39	1,717,699.21
Shuma me fond rezervë	5,106,495.93	574,199.52	13,318,981.39	18,999,676.84
				-
Struktura transporti				-
Punime germimi (Manuali 3)		110,041.06	605,935.84	715,976.90
Punime dheu (Manuali 2)			107,049.60	107,049.60
Punime shtresash (Manuali nr 3)		467,554.26	2,903,687.42	3,371,241.68
Punime betoni e betonarme (Manuali nr 3)		45,629.46	1,198,879.11	1,244,508.57
Analiza teknike (Manuali nr 3)		56,607.14	1,051,976.16	1,108,583.30
Punime shpyllezimi (Manuali nr 3)		4,082.97	9,231.12	13,314.09
Punime hekurbetoni (Manuali nr 3)			1,290,642.88	1,290,642.88
Ujesjelles kanalizime (Manuali nr 2)		91,453.31		91,453.31
Shuma		775,368.20	7,167,402.13	7,942,770.33
				-
Sisteme teknike				-
Gaz dhe naftesjelles	2,552,602.06	636,155.74	4,761,753.24	7,950,511.04
Analiza jashte liste	5,386,413.08	1,512,275.95	17,182,692.39	24,081,381.42
Pajisje jashte liste	452,000.00	-	470,850.00	922,850.00
Shuma	8,391,015.14	2,148,431.69	21,944,445.63	32,483,892.46
				-
Shuma Punime ndërtimi + Struktura transporti + Sisteme teknike	12,665,544.73	3,396,115.93	41,194,979.76	57,256,640.42
Fond rezerve 3 %	379,966.34	101,883.48	1,235,849.39	1,717,699.21

Shuma	13,045,511.07	3,497,999.41	42,430,829.15	58,974,339.63
Pajisje jashte liste	452,000.00	-	470,850.00	922,850.00
Shuma	13,497,511.07	3,497,999.41	42,901,679.15	59,897,189.63

Në mënyrë të detajuar për Depo 200 m³ llogaritjet nga autoriteti kontraktor janë si më poshtë:

RMV 200 m3	Stacioni Zharres QPN Fier	Impianti Injektimt Gorisht	Sektori Gorisht QPN Gorisht	Gr nr 2 Sektori Gorisht QPN Gorisht	Gr 11 Sektori Kocul QPN Gorisht	Gr 14 Sektori Kocul QPN Gorisht	Gr 9 Sektori 3 Kocul QPN Gorisht	Stacioni 06 QPN Fier	Totali
PUNIME NDERTIMI									
Analiza teknike per punimet dhe Instalmet teknologjike (Manuali nr 4 duhet tek sistemet teknike)	2230794.20	1,425,142.06	1,425,142.06	1,425,142.06	1,425,142.06	1,425,142.06	1,425,142.06	1,185,277.44	11,966,924.00
Punime bojatisje	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	116,208.00
Shuma	2245320.20	1439668.06	1439668.06	1439668.06	1439668.06	1439668.06	1439668.06	1199803.44	12,083,132.00
Fond rezerve 3%	217147.52	145,526.08	145,526.08	145,526.08	145,526.08	145,526.08	145,526.08	145,545.39	1,235,849.39
Shuma	2462467.72	1585194.14	1585194.14	1585194.14	1585194.14	1585194.14	1585194.14	1345348.83	13,318,981.39
Struktura transporti									
Punime germimi (Manuali 3)	77158.00	77,158.68	77,158.68	77,158.69	77,158.68	77,158.68	77,158.69	65,825.74	605,935.84
Punime dheu (Manuali 2)	15292.80	15,292.80	15,292.80	15,292.80	15,292.80	15,292.80	15,292.80		107,049.60
Punime shtresash (Manuali nr 3)	383639.80	383,639.80	383,639.80	383,639.80	383,639.80	383,639.80	383,639.80	218,208.82	2,903,687.42
Punime betoni e betonarme (Manuali nr 3)	202698.82	155,165.89	155,165.89	155,165.89	155,165.89	155,165.89	155,165.89	65,184.95	1,198,879.11
Analiza teknike (Manuali nr 3)	135302.40	135,302.40	135,302.40	135,302.40	135,302.40	135,302.40	135,302.40	104,859.36	1,051,976.16
Punime shpyllezimi (Manuali nr 3)	1153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	9,231.12
Punime hekurbetoni (Manuali nr 3)	360365.80	155,046.18	155,046.18	155,046.18	155,046.18	155,046.18	155,046.18		1,290,642.88
Shuma	1,175,611.51	922,759.64	922,759.64	922,759.65	922,759.64	922,759.64	922,759.65	455,232.76	7,167,402.13
Sisteme teknike									
Gaz dhe naftesjelles	673085.96	586,078.70	586,078.70	586,078.70	586,078.70	586,078.70	586,078.70	572,195.08	4,761,753.24
Analiza jashte liste	3144232.25	1,902,363.09	1,902,363.09	1,902,363.09	1,902,363.09	1,902,363.09	1,902,363.09	2,624,281.60	17,182,692.39
Pajisje jashte liste	470850.00								470,850.00
Shuma	3,817,318.21	2,488,441.79	2,488,441.79	2,488,441.79	2,488,441.79	2,488,441.79	2,488,441.79	3,196,476.68	21,944,445.63
Shuma	7,455,397.44	4,996,395.57	4,996,395.57	4,996,395.58	4,996,395.57	4,996,395.57	4,996,395.58	4,997,058.27	42,430,829.15
Pajisje jashte liste	470850.00								470,850.00
Shuma me pajisje pa tvsh									42,901,679.15

LLOGARITAJ E VLERES SE PUNIMEVE SIPAS EKSPERTIT

C. Varianti sipas metodologjise te perzgjedhur nga Enti Prokurues

Ne llogaritjen që kam kryer për vlerën e punimeve i jam referuar metodologjisë së përdorur nga autoriteti kontraktor du ke bere në vlerën totale të objektit grupimet e punimeve sipa references te analizes se cmimeve si më poshtë

- Çmimet e referuara Manualit nr 2 Punime ndërtimi
- Çmimet e referuara Manualit nr 3 Struktura Transporti
- Çmimet e referuara Manualit nr 4 Sisteme teknike

Fondi rezervë është llogaritur për cdo grup punimesh

Punime ndertimi	RMV 400	RMV 100 m3	RMV 200 m3	Totali
Punime shtresash	293,174.86			293,174.86
Punime dheu (Manuali 2)	43,140.28		107,049.60	150,189.88
Punime shtresash (Manuali nr 2)	32,928.72			32,928.72
Punime hekurbetoni	192,760.52			192,760.52
Punime hidroizolimi e catie	771,625.57			771,625.57
Punime dyer dritare	42,466.38			42,466.38

Punime bojatisje		7,263.00	116,208.00	123,471.00
Ujesjelles kanalizime (Manuali nr 2)		91,453.31		91,453.31
Instalime ndricimi	7,046.30			7,046.30
Punime betoni e betonarme (Manuali nr 2)	35,735.40			35,735.40
Shuma	1,418,878.03	98,716.31	223,257.60	1,740,851.94
Fond rezerve 3 %	42,566.34	2,961.49	6,697.73	52,225.56
Shuma	1,461,444.37	101,677.80	229,955.33	1,793,077.50
Struktura transporti				-
Punime germimi (Manuali 3)		110,041.06	605,935.84	715,976.90
Punime shtresash (Manuali nr 3)		467,554.26	2,903,687.42	3,371,241.68
Punime shpyllezimi (Manuali nr 3)	1,331.40			1,331.40
Punime betoni e betonarme (Manuali nr 3)		45,629.46	1,198,879.11	1,244,508.57
Analiza teknike (Manuali nr 3)		56,607.14	1,051,976.16	1,108,583.30
Punime shpyllezimi (Manuali nr 3)		4,082.97	9,231.12	13,314.09
Punime hekurbetoni (Manuali nr 3)			1,290,642.88	1,290,642.88
Shuma	1,331.40	683,914.89	7,060,352.53	7,745,598.82
Fond rezerve 3 %	39.94	20,517.45	211,810.58	232,367.96
Shuma	1,371.34	704,432.34	7,272,163.11	7,977,966.78
Sisteme teknike				-
Gaz dhe naftesjelles	2,552,602.06	636,155.74	4,761,753.24	7,950,511.04
Analiza teknike per punimet dhe Instalmet teknologjike (Manuali nr 4 duhet tek sistemet teknike)	3,306,320.16	465,053.04	11,966,924.00	15,738,297.20
Analiza jashte liste	5,386,413.08	1,512,275.95	17,182,692.39	24,081,381.42
Pajisje jashte liste	452,000.00	-	470,850.00	922,850.00
Shuma pa Pajisje	11,245,335.30	2,613,484.73	33,911,369.63	47,770,189.66
Fond rezerve 3 %	337,360.06	78,404.54	1,017,341.09	1,433,105.69
Shuma me fond rezerve pa pajisje	11,582,695.36	2,691,889.27	34,928,710.72	49,203,295.35
Totali me pajisje pa tvsh	13,045,511.07	3,497,999.41	35,399,560.72	50,126,145.35
Totali RMV 200 m³	13.497.511,07	3.497.999.41	42.901.679.15	59.897.189.63

Për punimet ne RMV 200 m³ llogaritja analitike eshtë si më poshtë:

	Stacioni Zharres QPN Fier	Impianti Injektimit Gorisht	Sektori Gorisht QPN Gorisht	Gr nr 2 Sektori Gorisht QPN Gorisht	Gr 11 Sektori Kocul QPN Gorisht	Gr 14 Sektori Kocul QPN Gorisht	Gr 9 Sektori 3 Kocul QPN Gorisht	Stacioni 06 QPN Fier	Totali
RMV 200 m3									
PUNIME NDERTIMI									
Punime dheu (Manuali 2)	15,292.80	15,292.80	15,292.80	15,292.80	15,292.80	15,292.80	15,292.80		107,049.60
Punime bojatisje	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	14,526.00	116,208.00
Shuma	29,818.80	29,818.80	29,818.80	29,818.80	29,818.80	29,818.80	29,818.80	14,526.00	223,257.60
Fond rezerve 3%	894.56	894.56	894.56	894.56	894.56	894.56	894.56	435.78	6,697.73
Shuma	30,713.36	30,713.36	30,713.36	30,713.36	30,713.36	30,713.36	30,713.36	14,961.78	229,955.33
Struktura transporti									
Punime germimi (Manuali 3)	77,158.00	77,158.68	77,158.68	77,158.69	77,158.68	77,158.68	77,158.69	65,825.74	605,935.84
Punime shtresash (Manuali nr 3)	383,639.80	383,639.80	383,639.80	383,639.80	383,639.80	383,639.80	383,639.80	218,208.82	2,903,687.42
Punime betoni e betonarme (Manuali nr 3)	202,698.82	155,165.89	155,165.89	155,165.89	155,165.89	155,165.89	155,165.89	65,184.95	1,198,879.11
Analiza teknike (Manuali nr 3)	135,302.40	135,302.40	135,302.40	135,302.40	135,302.40	135,302.40	135,302.40	104,859.36	1,051,976.16
Punime shpyllezimi (Manuali nr 3)	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	1,153.89	9,231.12
Punime hekurbetoni (Manuali nr 3)	360,365.80	155,046.18	155,046.18	155,046.18	155,046.18	155,046.18	155,046.18		1,290,642.88
Shuma	1,160,318.71	907,466.84	907,466.84	907,466.85	907,466.84	907,466.84	907,466.85	455,232.76	7,060,352.53
Fond rezerve 3%	34809.56	27224.01	27224.01	27224.01	27224.01	27224.01	27224.01	13656.98	211,810.58
Shuma	1,195,128.27	934,690.85	934,690.85	934,690.86	934,690.85	934,690.85	934,690.86	468,889.74	7,272,163.11
Sisteme teknike									
Analiza teknike per punimet dhe Instalmet teknologjike (Manuali nr 4 duhet tek sistemet teknike)	2,230,794.20	1,425,142.06	1,425,142.06	1,425,142.06	1,425,142.06	1,425,142.06	1,425,142.06	1,185,277.44	11,966,924.00
Gaz dhe naftesjelles	673,085.96	586,078.70	586,078.70	586,078.70	586,078.70	586,078.70	586,078.70	572,195.08	4,761,753.24
Analiza jashte liste	3,144,232.25	1,902,363.09	1,902,363.09	1,902,363.09	1,902,363.09	1,902,363.09	1,902,363.09	2,624,281.60	17,182,692.39
Pajisje jashte liste	470,850.00								470,850.00
Shuma	6,048,112.41	3,913,583.85	3,913,583.85	3,913,583.85	3,913,583.85	3,913,583.85	3,913,583.85	4,381,754.12	33,911,369.63
Fond rezerve 3%	181,443.37	117,407.52	117,407.52	117,407.52	117,407.52	117,407.52	117,407.52	131,452.62	1,017,341.09
Shuma	6,229,555.78	4,030,991.37	4,030,991.37	4,030,991.37	4,030,991.37	4,030,991.37	4,030,991.37	4,513,206.74	34,928,710.72
Shuma me Pajisje pa tvsh	6,700,405.78	4,030,991.37	4,030,991.37	4,030,991.37	4,030,991.37	4,030,991.37	4,030,991.37	4,513,206.74	35,399,560.72
Totali	7,926,247.42	4,996,395.57	4,996,395.57	4,996,395.59	4,996,395.57	4,996,395.57	4,996,395.59	4,997,058.27	42,901,679.15

D. Varianti I përlllogaritjes sipas vlerës së plotë të objektit

Ky është varuanti është më i saktë i vlerës supervizimit duke përjashtuar çdo lloj abuzimi të operatorëve ekonomik për të marrë nga Enti prokurues preventivin e projektit apo mënyrën e llogaritjes së fondit limit të supervizimit të objektit.

Vlera e supervizimit llogaritet për vlerën e plotë të objektit duke marrë në konsideratë përqindjen më të madhe të punimeve të parashikuar në preventivin e projektit. Pra vlera e supervizimit duhet ti referohej në mënyrë të plotë vlerës së objektit 59.897.189.63 lekë dhe duke e trajtuar në grupin e tretë tarifor për këto sisteme.

LLOGARITJA E VLERËS SË SUPERVIZIMIT NË BAZË TË VKM NR 354 DATË 11.05.2016 “PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIMIN E TERRITORIT, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM METODOLOGJIA E PËRDORUR

Për përcaktimin e vlerës së supervizimit teknik të punimeve është marrë për bazë:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe manuali përkatës, i cili përcakton nivelin në përqindje të tarifave për shërbimet e mbikëqyrjes, në varësi të vlerës së ndërtimit të objektit.

Hapat për llogaritjen e vlerës së mbikëqyrjes:

4. **Përcaktimi i kategorisë së objektit:** Kategoria e objektit këtu duhej të ishte trajtuar si Sisteme teknike pasi vlera e punimeve të ndërtimit dhe të strukturës rrugore është e vogël kundrejt vlerës totale të objektit (punimet e ndërtimit në masën 3% të totalit të punimeve dhe punimet e strukturës rrugore në masën 13 % të totalit të punimeve).
5. **Gjetja e përqindjeve për mbikëqyrje:** Në manualin e tarifave, për veprat inxhinierike janë përcaktuar përqindjet minimale dhe maksimale për shërbimin e mbikëqyrjes. Këto përqindje aplikohen mbi vlerën e ndërtimit të objektit për të llogaritur vlerën e mbikëqyrjes.
6. **Llogaritja e vlerës së mbikëqyrjes:** Pasi janë përcaktuar përqindjet përkatëse, shumëzohen këto përqindje me vlerën totale të ndërtimit të veprës për të marrë vlerën minimale dhe maksimale të mbikëqyrjes.

Ne bazë të VKM nr 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim, Shtojca nr 1, llogaritja e koeficientit minimum dhe maksimum behet sipas metodologjise së mëposhtme:

Në rast se kostoja e llogaritëshme ($X = \text{vlera e preventivit}$), është një vlerë e cila nuk gjendet në tabelë atëherë do të përdorimin formulën e interpolimit për të gjetur tarifën, e cila do të llogaritet si më poshtë:

Në fillim do të gjejmë në tabelë kostot e llogaritëshme, mes të cilave ndodhet kostoja e llogaritëshme (X) për të cilën duam të llogarisim tarifën. Kostoja e llogaritëshme $K1$ me vlerë minimale (a) vlerë maksimale (b) Kostoja e llogaritëshme $K2$ me vlerë minimale (c) vlerë maksimale (d)

Llogarisim koston minimale/maksimale mes vlerave a dhe b sipas formulës: $H1 = a + (0 \div 1) \times (b - a)$

Llogarisim koston minimale/maksimale mes vlerave c dhe d sipas formulës: $H2 = c + (0 \div 1) \times (d - c)$

Llogarisim diferencën e kostove të llogaritëshme reale $X - K1 = D1$

Llogarisim diferencën mes dy kostove $K2 - K1 = D2$

Llogarisim diferencën minimale/maksimale: $H2 \div H1 = D3 \text{ min}$ $H2 \div H1 = D3 \text{ max}$

Formula e interpolimit për tarifën minimale, do të jetë:

$$H1 + \frac{D3 \text{ min} \times D1}{D2}$$

$$a + 0 \times (b - a) + \frac{(c + 0 \times (d - c)) - [a + 0 \times (b - a)]}{K2 - K1} \times (X - K1) = \text{tarifa minimale}$$

Formula e interpolimit për tarifën maksimale do të jetë

$$H1 + \frac{D3 \text{ max} \times D1}{D2}$$

$$a + 1 \times (b - a) + \frac{(c + 1 \times (d - c)) - [a + 1 \times (b - a)]}{K2 - K1} \times (X - K1) = \text{tarifa maksimale}$$

Për vlerat e punimeve që janë nën vlerën minimale të përcaktuar në tabelat e përlllogaritjes së koeficientëve llogaritja bëhet si më poshtë:

Duke qenë se vlera e objektit është më e vogël se kufiri më i ulët i përcaktuar në tabelën përkatëse të manualit, është zbatuar përcaktimi në VKM nr. 354, datë 11.05.2016:

“Nëse kostot e llogaritshme të identifikuara qëndrojnë jashtë vlerave tabelare të këtij manuali, tarifat sipas rastit janë më të larta apo më të ulëta të llojit apo grupit tarifar përkatës të shërbimit, duke përdorur koeficientin e ndryshimit përkatës në mënyrë zbritëse apo rritëse.”

Llogaritet koeficienti rritës meqënesë vlera është më e vogël se vlera minimale e përcaktuar në tabelë

IV. LLOGARITJA E VLERËS SË SUPERVIZIMIT

Vlera minimale e supervizimit = vlerën minimale të projektimit shumëzuar me përqindjen e supervizimit sipas llojit të punimeve dhe grupit ku përfshihet objekti

Diferenca e koeficientit nga vlera minimum e objektit në tabele $\Delta k = (b - a) / K$

c- koeficienti minimal për vlerën minimale të përcaktuar në tabele

d- koeficienti maksimal nga vlera minimum e objektit në tabele

k- Vlera minimale e kushtimit të veprës e përcaktuar në tabelë

llogaritet $D = X - K$ ku

X është vlera jone

K vlera minimale në tabele

D- diferenca ndërmjet vlerës minimale në tabelë dhe vlerës tonë

K është vlera minimale

*Rritja e koeficientit minimal është $D2 = D * \Delta k$*

Koeficienti minimal llogaritet $a + D2$

Koeficienti maksimal llogaritet $b + D2$

Në llogaritjen e vlerës së supervizimit ekzistojnë dy metoda

1. Metoda me interpolim në koeficient projektimi:

*Koeficienti minimal i interpoluar: Koeficienti minimal * % e përcaktuar për supervizim*

Tarifa minimale: Vlera e objektit x Koeficientit minimal

*Koeficienti maksimal i interpoluar: Koeficienti maksimal * % e përcaktuar për supervizim*

Tarifa maksimale: Vlera e Objektit x Koeficienti maksimal

2. Metoda me interpolim në vlera absolute:

Interpolimi është kryer direkt në vlerat e tarifës për kufijtë minimal dhe maksimal.

Tarifa minimale e interpoluar në lekë

Tarifa maksimale e interpoluar: në lekë

Koeficientët efektivë që rezultojnë nga këto vlera janë:

Minimal: Vlera minimale në raport me vlerën e objektit e nxjerre në %

Maksimal: Vlera maksimale në raport me vlerën e objektit e nxjerre në %

Vlerat minimale dhe maksimale shumëzohen me përqindjen e supervizimit

Në këtë përlllogaritje është aplikuar interpolimi linear në vlera absolute të tarifës për dy kufijtë e përcaktuar në VKM. Si pasojë, koeficienti efektiv që rezulton nga ndarja e tarifës së interpoluar me vlerën e objektit është pak më i ulët se ai që do të rezultonte nga interpolimi i drejtpërdrejtë i përqindjeve. Kjo diferencë është e natyrshme për shkak të karakterit jo-linear të përqindjes ndaj vlerës dhe është teknikisht e pranueshme për përdorim në përlllogaritje të thjeshtuara ose kur mungojnë koeficientët e saktë.

Në bazë të VKM 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” Shtojca 1 referuar Nenit nr 13 Interpolimi, ku thuhet: Në rast se kostoja e llogaritëshme (X = vlera e preventivit), është një vlerë e cila nuk gjendet në tabelë atëherë do të përdorimin formulën e interpolimit për të gjetur tarifën, I kam llogaritur përqindjen e tarifës së supervizimit në të dy metodat dhe për vlerën e supervizimit i jam referuar Metodes se dyte, pasi metodat e mësipërme kanë devijime ndermjet njera tjetres që ndikon në përcaktimin e saktë të vlerës minimale të supervizimit. Meqënëse nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” i referohet vlerës dhe une kam marrë për tarifë të saktë tarifën e bazuar në nxjerrjen e vlerave maksimum dhe minimum.

Në bazë të metodologjisë së mësipërme Llogaritja e supervizimit sipas entit kontraktor e korrigjuar del si me poshtë:

**Llogaritja sipas entit
kontraktor**

	RVM 400 m3	RVM 100 m3	RVM 200 m3	Totali
Punime ndertimi	5,106,495.93	574,199.52	13,318,981.39	18,999,676.84
Punime infrastrukture	-	775,368.20	7,167,402.13	7,942,770.33
Sisteme teknike	8,391,015.14	2,148,431.69	22,415,295.63	32,954,742.46
Shuma	13,497,511.07	3,497,999.41	42,901,679.15	59,897,189.63

Grupi V per ndertesat
Grupi III tarifar Strukture
transporti

Grupi III tarifar per
sistemet teknike

**Vlera minimum
supervizimi**

	RVM 400 m3	RVM 100 m3	RVM 200 m3	Totali
Punime ndertimi	88,770.43	10,091.56	221,520.73	320,382.72
Punime infrastrukture	-	17,348.86	136,735.26	154,084.12
Sisteme teknike	147,511.40	66,434.53	397,691.05	611,636.99
Shuma Vlera minimum	236,281.83	78,210.61	755,947.04	1,070,439.48

**Vlera maksimum
supervizimi**

	RVM 400 m3	RVM 100 m3	RVM 200 m3	Totali
Punime ndertimi	97,331.09	11,887.24	242,678.95	351,897.28
Punime infrastrukture	-	23,280.43	159,292.35	182,572.78
Sisteme teknike	231,771.85	78,626.15	467,105.39	777,503.40
Shuma Vlera maksimum	329,102.94	113,793.82	869,076.70	1,311,973.46

Sipas metodologjise së entit kontraktor duke bërë sistemimet e punimeve në bazë të analizave të përdorura llogaritja e vleres maksimale dhe minimale te supervizimit sipas llogaritjet të kryer nga Eksperti del si me poshtë:

Llogaritja e supervizimit	Vlera	Min Supervizim	Max Superviz
Punime ndertimi	1,793,077.50	31,513.34	34,561.57
Punime infrastrukture	7,977,966.78	148042.64	171946.92
Sisteme teknike	50,126,145.35	741994.84	850872.28
Total	59,897,189.63	921,550.81	1,057,380.77

Në bazë të përlllogaritjes se vleres se supervizimit duke e marrë si objekt të vetëm vlera minimale dhe maksimale e supervizimit del si me poshte:

Llogaritja si objekt I vetem Sisteme teknike

Vlera e objektit	Totali	Vlera min supervizimi	Vlera max supervizimi
Objekti ne total	59,897,189.63	866,715.62	992,880.16

Ne mënyrë analitike llogaritjet jane sipas tabelave në excel bashkelidhur

V. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në përputhje me VKM nr. 354, datë 11.05.2016 dhe në bazë të llogaritjes sipas përqindjeve progresive për vlerat ndërmjetëse, vlera minimale e supervizimit teknik për objektin me vlerë ndërtimi 59,897,189.63 lekë pa tvsh është:

Nga Enti Prokurues Vlera minimum dhe vlera limit e supervizimit pas korrigjimeve të vlerave pjesore të objekteve nga ana aritmetike duhej të ishte:

1,070,439.48 (një million e shtatëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetëe nëntë pikë dyzet e tetë) lekë, pa TVSH.

Vlera limit e supervizimit 1,311,973.46 (një milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre pikë dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

Në bazë të përlllogaritjes së mësipërme Autoriteti kontraktor ka devijim të llogaritjes si nga vlera limit e supervizimit ashtu dhe për llogaritjen e vlerës minimum të supervizimit për dy arsye:

c. Coptimit të fondit të ndërtimit në tre grupe dhe për çdo grup në tre nëngrupe gjë që con në rritje artificiale të vlerës së supervizimit

d. Gabimeve aritmetike të kryera Brenda nen grupeve në objektin RVM 200 m³

Kjo ka bërë që operatorët ekonomikë të konkurojnë nën vlerën minimum të përcaktuar nga Enti prokurues pasi nuk kanë pasur të qartë kërkesës e Entit prokurues nëse duhet të konkurojnë kundrejt vlerës totale të objektit apo kundrejt grupimit të punimeve sipas manualit.

Në bazë të grupimit të punimeve sipas llojit të tyre të ndara vetëm në tre grupe për të gjitha llojet e punimeve sipas RVM vlera minimum e supervizimit dhe vlera limit e supervizimit paraqitet si më poshtë:

Llogaritja e supervizimit	Vlera	Min Supervizim	Max Superviz
---------------------------	-------	----------------	--------------

Punime ndertimi	1,793,077.50	31,513.34	34,561.57	Grupi V per ndertesat Grupi III tarifar Strukture transporti Grupi III tarifar per sistemet teknike
Punime infrastrukture	7,977,966.78	148042.64	171946.92	
Sisteme teknike	50,126,145.35	741994.84	850872.28	
Total	59,897,189.63	921,550.81	1,057,380.77	

Në mënyrë të saktë Vlera limit e supervizimit dhe vlera limit e supervizimit duhej të llogariteshin mbështetur në vlerën e plotë të projektit pasi punimet civile dhe të infrastruktures rrugore nuk kanë vlerë të konsiderueshme referuar vlerës totale të objektit.

Nëse do ishin mbështetur në këtë llogjikë vlera limit e supervizimit dhe vlera minimum do të ishte si më poshtë:

Vlera e objektit	Totali	Vlera min supervizimi	Vlera max supervizimi
Objekti në total	59,897,189.63	866,715.62	992,880.16

Konkluzion

*Oferta e ofruar nga Operatori Ekonomik C.E.C GROUP prej 1.086.998,76 lekë; nuk është vlerë anomalisht e ulët në asnjë rast të llogaritjes së vlerës minimum të supervizimit sipas tabelave të përshkruara më sipër pasi vlera minimale që duhej të kishte Enti prokurues sipas metodologjisë të përdorur prej tij duke I bërë vetëm korrigjimet aritmetike te vlerave te RVM 200 m3 del **1,070,439.48 lekë**.*

Në përgjigje të pyetjeve drejtuar ekspertit me shkresën e Komisionit të prokurimit publik Nr 1172/14 prot. datë 29.05.2025 “Pyetje drejtuar ekspertit” përgjigjet janë si më poshtë:

1. A është përlllogaritur fondi limit për procedurën e prokurimit objekt ankimi nga autoritetit kontraktor në përputhje me VKM nr. 354 , datë 11.05.2016

Nga sa kam sqaruar më lart llogaritja e vlerës limit nga ana e autoritetit kontraktor është kryer gabim dhe ka deformim të vlerës limit të objektit, për efekt të copëtimit të fondeve në grupe dhe nën grupe që ka sjellë rritje të vlerës së objektit. Dhe në pyetjet për sqarim që i kemi dërguar Autoritetit kontraktor për këtë copim të fondeve, nuk kemi marrë përgjigje.

2. Sa është kufiri minimal dhe maksimal i shërbimit të supervizimit për procedurën e prokurimit “Ndërtim Montim i disa RVM-ve në Qëndrat e Albpetrol sh.a me fond limit 59.897.190 lekë pa tvsh, referuar VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Në bazë të metodologjisë së përdorur nga Enti prokurues duke kryer vetëm korrigjimet aritmetike tek RVM 200 m³. vlera minimum duhet të ishte 1,070,439.48 lekë pa tvsh dhe vlera limit duhet të ishte 1,311,973.46 lekë pa tvsh.

Rekomandime

Nëse Enti Prokurues bën në ndarjen e punimeve në grupe sipas llojit të tyre duhet të orientojë operatorët ekonomikë minimum në përqindjen që zë secili prej tyre kundrejt punimeve në total të objektit .

III.1.8. Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik.

III.1.9. Në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të procedurës së prokurimit dhe korrespondencës së mbajtur me autoritetin kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, ekzistojnë kushte objektive që justifikojnë anulimin e procedurës së prokurimit, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se ndër qëllimet kryesore të ligjit të prokurimit publik janë ai i sigurimit të një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dhe sigurimit të integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik. Ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

Nga shqyrtimi i informacionit të dërguar nga e autoritetit kontraktor si edhe të raportit të ekspertes Ing. A. T., Komisioni vlerëson se, nga krahasimi i vlerave të përllogaritura për fondin limit të procedurës objekt ankimi, ato nuk janë të njëjta. Konkretisht, në raportin e dërguar nga ekspertia Ing. A.T, janë argumentuar dhe ilustruar në trajtë narrative dhe në trajtë tabelare, metodologjia e përdorur për përcaktimin e vlerës së supervizimit teknik të punimeve duke iu referuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe manuali përkatës, i cili përcakton nivelin në përqindje të tarifave për shërbimet e mbikëqyrjes, në varësi të vlerës së ndërtimit të objektit. Në përfundim të këtij raporti, është konkluduar se, autotietit kontraktor në përllogaritjen e fodnit limit të procedurës objekt ankimi, llogaritja e vlerës limit të prokurimit për shërbimin e supervizimit është kryer sipas metodologjisë së mëposhtme

1. Objekti është ndarë në tre grupe Depo 400 m³, Depo 100 m³ dhe Depo 200 m³.
2. Secili grup i përzgjedhur në bazë të referencës së analizës të çmimeve është ndarë në 3 nëngrupe
3. Punime ndërtimi referuar analizave të çmimit të Manualit nr. 2 të çmimeve të miratuara në vitin 2023
4. Punime infrastrukture rrugore referuar analizave të çmimeve të Manualit nr 3 të çmimeve të miratuara në vitin 2023
5. Punime sisteme teknike referuar analizave të çmimeve të Manualit nr 4 të çmimeve të miratuara në vitin 2023
6. Sipas vlerave të përcaktuara si vlera ndërtimore për çdo nëngrup në grupet kryesore janë përcaktuar vlerat minimale dhe maksimale të supervizimit dhe vlera totale limit e supervizimit është nxjerrë si shumatore e këtyre nënvlerave.
7. Gjatë grupimit të vlerave të ndara në punime ndërtimi, infrastrukture dhe sisteme teknike vlerat totale në grupe të mëdha sipas llojit të depove janë të sakta ndërsa në nëndarjen e mëtejshme janë gabimet si më poshtë:

g. Objekti RMV 400 m³

- Zëri Analiza teknike për punimet dhe Instalimet teknologjike me vlerë 3.306.320.16 lekë pa tvsh i cili i është referuar në analizë çmimi Manualit nr. 4, është vendosur gabim në kapitullin Punime ndërtimi (duhej llogaritur në Sistemet teknike)
- Punime Shpyllëzimi me vlerë 1.331,40 referuar në Analizë manualit nr. 3 të çmimeve për punime infrastrukturë rrugore, është vendosur gabim në punime ndërtimi.

h. Objekti RMV 100 m³

- Zëri Analiza teknike për punimet dhe Instalimet teknologjike me vlerë 465.053.04 lekë pa tvsh i cili i është referuar në analizë çmimi Manualit nr 4, është vendosur gabim në kapitullin Punime ndërtimi (duhej llogaritur në Sistemet teknike)

i. Objektet RMV 200 m³ të ndara në 8 nënobjekte

- Sipas përshkrimit të zërave të punës të sqaruara nga Autoriteti kontraktor në shkresën nr 2753/1 datë 04.06.2025 “Kthim përgjigje” për objektet RMV 200 m³ nuk përputhen shifrat totale sipas grupimit të punimeve si më poshtë:
 - Punime ndërtimi vlera e ndërtimit e raportuar prej tyre është 14.507.468,82 lekë. Pas kryerjes së veprimeve për çdo zë të llogaritur prej tyre në punime ndërtimi vlera del 13.318.981,39 lekë
 - Punime infrastrukturë rrugore e raportuar prej tyre është 6.450.765.08 lekë. Pas kryerjes së veprimeve për çdo zë të llogaritur prej tyre në punime infrastrukturë rrugore vlera del 7.167.402,13 lekë
 - Punime sisteme teknike e raportuar prej tyre është 21.943.445,6 lekë. Pas kryerjes së veprimeve për çdo zë të llogaritur prej tyre në punime sisteme teknike vlera del 21.944.445,63 leke
8. Fondi rezerve i llogaritur është përfshirë i plotë në masën 3% të çdo objekti në Punime ndërtimi, ndërsa infrastruktura rrugore dhe sistemet teknike janë llogaritur pa fond rezervë. Në preventivin e objektit fondi rezervë është llogaritur për të gjitha zërat e punimeve përjashtuar vetëm pajisjet. Kjo ka çuar në rritjen artificiale të zërave të punimeve të ndërtimit dhe në uljen e vlerave të punimeve të infrastrukturës rrugore dhe sistemeve teknike.
 9. Ndarja e punimeve në tre grupe të mëdha dhe ndarja e çdo grupi në tre nëngrupe ka çuar në rritje artificiale të vlerës limit të supervizimit, pasi referuar tabelave me rritjen e vlerës ulet koeficienti përlllogaritës.
 10. Nga ana e operatorëve ekonomik është pothuajse e pamundur llogaritja e vlerës minimum dhe maksimum e supervizimit pa dhënë orientime të mëtejshme enti prokurues pasi gjatë përgatitjes së ofertës asnjë operator ekonomik nuk ka në dorë preventivin e projektuesit për të bërë ndarjen e punimeve. Operatorit në dokumentat e prokurimit i është dhënë vlera totale limit dhe tarifat ky është mbështetur autoriteti kontraktor për llogaritjen e vlerës limit pa specifikuar se sa përqind të punimeve zënë punimet e ndërtimit, infrastruktura rrugore dhe sistemet teknike. Kjo gje ka bërë që vlerat e ofruar nga operatorët ekonomik të jenë nën vlerën minimum të llogaritur nga Enti prokurues.
 11. Gjithashtu, në këtë raport ekspertimi, është argumentuar dhe sqaruar në mënyrë analitike llogaritjet e kryera në metodologjinë e punës të bërë nga Enti prokurues duke pasqyruar vetëm ndryshimet për gabimet aritmetike të bëra prej tyre.

Në bazë të përlllogaritjes së mësipërme Autoriteti kontraktor ka devijim të llogaritjes si nga vlera limit e supervizimit ashtu dhe për llogaritjen e vlerës minimum të supervizimit për dy arsye:

- a. Coptimit të fondit të ndërtimit në tre grupe dhe për çdo grup në tre nëngrupe gjë që con në rritje artificiale të vlerës së supervizimit
- b. Gabimeve aritmetike të kryera Brenda nën grupeve në objektin RVM 200 m³

Kjo ka bërë që operatorët ekonomikë të konkurojnë nën vlerën minimum të përcaktuar nga Enti prokurues pasi nuk kanë pasur të qartë kërkesës e Entit prokurues nëse duhet të konkurojnë kundrejt vlerës totale të objektit apo kundrejt grupimit të punimeve sipas manualit. Në mënyrë

të saktë Vlera limit e supervizimit duhej të llogariteshin mbështetur në vlerën e plotë të projektit pasi punimet civile dhe të infrastruktures rrugore nuk kanë vlerë të konsiderueshme referuar vlerës totale të objektit.

Në përgjigje të pyetjeve drejtuar ekspertit me shkresën e Komisionit të prokurimit publik Nr 1172/14 prot. datë 29.05.2025 “Pyetje drejtuar ekspertit” përgjigjet janë si më poshtë:

1. A është përlllogaritur fondi limit për procedurën e prokurimit objekt ankimi nga autoriteti kontraktor në përputhje me VKM nr. 354 , datë 11.05.2016?

*Nga sa kam sqaruar më lart llogaritja e vlerës limit nga ana e autoritetit kontraktor është **kryer gabim dhe ka deformim të vlerës limit të objektit**, për efekt të copëtimit të fondeve në grupe dhe nën grupe që ka sjellë rritje të vlerës së objektit. Dhe në pyetjet për sqarim që i kemi dërguar Autoritetit kontraktor për këtë copim të fondeve, nuk kemi marrë përgjigje.*

2. Sa është kufiri minimal dhe maksimal i shërbimit të supervizimit për procedurën e prokurimit “Ndërtim Montim i disa RVM-ve në Qëndrat e Albpetrol sh.a me fond limit 59.897.190 lekë pa tvsh, referuar VKM nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

*Në bazë të metodologjisë së përdorur nga Enti prokurues duke kryer vetëm korrigjimet aritmetike tek RVM 200 m³. **vlera minimum duhet të ishte 1,070,439.48 lekë pa tvsh dhe vlera limit duhet të ishte 1,311,973.46 lekë pa tvsh.***

Rekomandime në raport ekspertimi:

Nëse Enti Prokurues bën në ndarjen e punimeve në grupe sipas llojit të tyre duhet të orientojë operatorët ekonomikë minimum në përqindjen që zë secili prej tyre kundrejt punimeve në total të objektit .

Komisioni gjykon, se një mënyrë e tillë e përlllogaritjes së vlerës së fondit limit nga ana e entit prokurues të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si dhe nga ana tjetër, ajo e ofertimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të interesuar, i ka vendosur ata në kushte pabarazie dhe në pajidejini të vlerës së saktë të fondit limit të procedurës së prokurimit. Komisioni gjykon, se anulimi i një procedure prokurimi është një e drejtë dhe përgjegjësi e autoritetit kontraktor, por me kushtin që të respektojë përcaktimet e nenit 98 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Për sa më sipër, KPP gjykon, se procedura e prokurimit objekt – ankimi, duhet të anulohet nga autoriteti kontraktor Albpetrol sh.a pasi mënyra se si operatorët ekonomikë kanë ofertuar, i ka vënë ata në kushte pabarazie. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e sipërpërmendur të prokurimit. Në rast rishpallje të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor të dërgojë dokumentat e tenderit që do të rishpallë, duke patur në konsideratë konstatimet në këtë vendim.

Sa më sipër, pretendimi operatorit ekonomik ankimues “C.E.C. GROUP” SHPK., qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike”, me nr. REF-44148-04-08-2025, me objekt: “Mbikëqyrje punimesh për objektin: Ndërtim-montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”, me fond limit: 1,249,423.86 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a..
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e sipërpërmendur të prokurimit. Në rast rishpallje së procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor të dërgojë dokumentat e tenderit që do të rishpallë, duke patur në konsideratë konstatimet në këtë vendim.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, (anulimin e procedurës së prokurimit).
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “C.E.C. GROUP” SHPK
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

